

**URDHËR**  
**Nr. 194, datë 3.5.2019**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN  
E STRUKTURËS TË SIGURISË PORTUALE TË “PORTIT MBM” NË ROMANO  
PORT DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 401, germa “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947”, dhe nenit 5, pika “b”, e ligjit nr. 168/2013, datë 31.10.2013 “Për sigurinë në anije dhe në porte”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës të sigurisë portuale të ‘Portit MBM’ Romano Port Durrës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
  2. Ngarkohet “Porti MBM”, Romano Port Durrës për zbatimin e këtij urdhri.
  3. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**Belinda Balluku**